



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 3 Prot.

Tiranë, më 21/05/2024

**V E N D I M**

**Nr. 3, datë 21/05/2024**

**P Ë R**

**MIRATIMIN E VULËS SË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE (KIZ)**  
**MIRATIMIN E VULAVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE NË**  
**FAKULTET/INSTITUT (KZF) DHE KRYETARIT, SI DHE MIRATIMIN E VULAVE TË**  
**KQV – VE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6, pika 2.6, neni 8 dhe 9, si dhe vendimin nr. 1, datë 20/05/2024 të KIZ” Për konstituimin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe zgjedhjen e kryetarit të tij”, në mbledhjen e datës 21.05.2024 Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,








**VENDOSI:**

1. Të miratojë modelin e vulës për Komisionin Institucional Zgjedhor.
  - 1.1 Vula do të jetë e rrumbullakët me përmasa standarde dhe në përmbajtje do të ketë emërtimin: Universiteti Politeknik i Tiranës, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve. Në qendër të vulës të shkruhet teksti: KIZ 2024-2028.
2. Të miratojë vulën për KZF-të/Institutin dhe Kryetarin e KZF-ve/Institutit.
  - 2.1 Vulat do të jenë të rrumbullakta me përmasa standarde dhe në përmbajtje do të kenë emërtimin: Universiteti Politeknik i Tiranës, emri i fakultetit/institutit përkatës. Në qendër të vulës të shkruhet teksti: KZF, akronimi i fakultetit/institutit (psh. FIN, IGEO etj), 2024-2028.
  - 2.2 Vula e Kryetarit të KZF-ve/Institutit në përmbajtje do të ketë emërtimin: Universiteti Politeknik i Tiranës, emri i fakultetit/institutit përkatës. Në qendër të vulës të shkruhet teksti: KZF, akronimi i fakultetit/institutit (psh. FIN, IGEO etj), KRYETARI.

3. Të miratojë vumat për Komisionet e Qendrave të Votimit KQV–ve dhe Kryetarit.
- 3.1 Vula e KQV–ve në përmbajtje do të ketë emërtimin: Universiteti Politeknik i Tiranës dhe emrin e fakultetit/institutit përkatës. Në qendër të vulës të shkruhet teksti KQV, akronimi i fakultetit/institutit (psh. FIN), 2024-2028.
- 3.2 Vula e Kryetarit të KQV-ve në përmbajtje do të ketë emërtimin: Universiteti Politeknik i Tiranës, emri i fakultetit. Në qendër të vulës të shkruhet teksti: KQV, akronimi i fakultetit (psh. FIN), KRYETARI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA	Kryetar 
Alfred PJETRI	Anëtar 
Albina BASHOLLI	Anëtar 
Anjeza DULAJ (GJINI)	Anëtar
Nelda KOTE	Anëtar 
Irida GJOKA (MARKJA)	Anëtar 
Klajdi QOSHI	Anëtar 
Pietro BELBA	Anëtar 
Lidia HYSA	Anëtar 